REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/ I 122-6 Prot. **Tiranë 08.03.2023**
Nr. Dok. 202201593/6

Lënda: *Rekomandim për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional të nëpunësve të Bashkisë Divjakë dhe per marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problematikës së strehimit të familjes J.*

BASHKISË DIVJAKË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nisur nga kronika e transmetuar në median "tvklan.al", në disa platforma të saj, konkretisht: emisionin investigativ "Stop", në datën 04.01.2023, ***"Divjakë/ Në karrige me rrota dhe bashkëshortin e sëmurë, qytetarja bën apel për ndihmë"***, ka filluar me nismën e tij ndjekjen e kësaj çështjeje
Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të hetimit administrativ për zgjidhjen e problematikës së ngritur nga qytetarja në ankesën publike, i është drejtuar me shkresat "Kërkesa për informacion" institucioneve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier dhe Bashkisë Divjakë.

Në përgjigje të shkresës sonë nr. K1/I122-2 Prot, datë 24.01.2023 "Kërkesë për informacion", Bashkia Divjakë (Sektori i Mirëqënies Sociale) na informon për ndihmën ofruar familjes J. në bashkëpunim me organizata joveritare, si; mbështetjen lidhur me pagesën e qerasë për banesë për dy vite e në vazhdim, për sigurimin e një karroce me bateri për lëvizjen e qytetares, për ndihmesën me ushqime e paketa ndihme, për vëmëndjen kushtuar kësaj familjeje lidhur me problematikën e ngritur në media për strehimin, ku kjo familje figuron në listë prioritare të qytetarëve të pastrehë të cilët do të ndihmohen në të ardhmen, si dhe për mundësitë e kufizuara të Bashkise Divjakë për zgjidhjen e ankesës së bërë publike për shkak të të ardhurave/buxhetit të ulët të kësaj Bashkie.
Në shkresën Tuaj nr. 6389/1 Prot, datë 15.11.2022 "Kthim Përgjigje" (tonës), shkruhet:

- *Kërkojmë nga ana juaj mbështetjen financiare për të bërë të mundur ndihmën e kësaj familjeje…(bashkëlidhur shkresa)*

Duke vlerësuar përpjekjet e deritanishme të institucionit tuaj për mbështetjen e dhënë familjes J., shqetësuese për Avokatin e Popullit mbetet fakti që në përmbajtjen e shkresës

suaj, konstatohet mosnjohje e legjislacionit bazë që rregullon fushën e veprimtarisë së organeve të vetëqeverisjes vendore, ligjit nr. 139/2015, ndryshuar me ligjin nr 38/2019 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe ligjin nr.22/2018 "Për Strehimin Social".
Konkretisht:
Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazën e parimit të decntralizimit të pushtetit dhe ushtrohet bazuar në parimin e autonomisë vendore (Kushtetuta e Republikës së Shqiperisë, neni 13 dhe Ligji nr. 39/2019 neni 4, pika 1). Më tej:

Ligji nr. 39/2019 parashikon se:
Neni 9; Të drejtat dhe përgjegjësitë;
pika 1.2 a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
pika 1.4. Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:
a) për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;
Neni 22; Parimet për ushtrimin e funksioneve;
1.Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.
3.<u>Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare</u>.

Ligji nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" parashikon se:
Kreu III; Programet socilale të strehimit;
neni 11; përcakton llojet e programeve sociale të strehimit, si dhe detyrimin që njësitë e qeverisjes vendore kanë kundrejt qytetarëve të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore:
Kreu IV; Programi i banesave me qera;
neni 17; përcakton kuptimin e e programit të banesave sociale me qira,
neni 18; i kushtohet fondit publik të banesave sociale,
neni 19; përcakton kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit.

Në këtë këndvështrim, njohja dhe zbatimi korrekt i ligjit është element thelbësor jo vetëm për imazhin e administratës publike, e cila duhet të përfaqësojnë një trupë të specializuar nëpunësish që shërbejnë në funksion të interesit më të lartë publik, por dhe për zgjidhje afatgjatë të problematikave të hasura nga qytetarët, pjesë e grupeve në nevojë që plotësojnë kushtet ligjore për banesat sociale.

Sa më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në njesitë organizative të shërbimit social të Bashkisë Divjakë, por jo vetëm, mbi njohjen e legjislacionit që rregullon fushën e shërbimeve

sociale dhe veprimtarinë e pushtetit vendor, duke qëndruar në koherencë me dinamikën e legjislacionit shqiptar në fuqi.
Legjislacioni i shërbimit civil ka rregulluar me një kuadër të posaçëm çështjen e formimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë, duke krijuar një institucion të dedikuar për trajnimin e nëpunësve civilë, që është Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Nga ana tjetër, theksi tek nevoja për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të nëpunësve civilë është vendosur edhe nga Vendimi nr. 1037, datë 16/12/2015 i Këshillit të Ministrave, "*Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë*", i cili parashikon procedura të hollësishme sa i takon përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë me synim aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil.

Në përfundim, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

R E K O M A N D O N:

1) *Marrjen e masave për hartimin dhe zbatimin e një plani për formimin e vazhdueshëm profesional dhe realizimin e trajnimeve për punonjësit e Bashkisë Delvinë, për njohjen e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e pushtetit vendor dhe rolin e tyre, atë të mbrojtjes sociale, rolin e Avokatit të Popullit si dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vend.*

2) *Marrjen e masave të nevojshme bazuar në legjislacionin në fuqi, për një zgjidhje të problemit të strehimit të familjes J..*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA
DV